


KRONIKĚ E ZE ZĚ

Prokuroria thotë se plagosja në Shtërpçë erdhi pas mosmarrëveshjes verbale



Prokuroria Themeiore në Ferizaj ka kërkuar një muaj paraburgim ndaj të pandehurit A.K., nën dyshimin për plagosjen e dy personave në Shtërpcë një ditë më parë. Sipas njoftimit, ai dyshohet për “vrasje në tentativë”. Prokuroria ka thënë se të shtënat kanë ndodhur pas një mosmarrëveshjeje verbale të ndodhur aty për aty.

A.K., që u konfirmua se është pjesëtar i FSK-së, dyshohet se plagosi të shtunën dy qytetarë serbë. Menjëherë pati protestë të serbëve në Gotovushë të Shtërpcës. Ata bllokuan rrugën magjistrale për disa orë.

"Sipas kërkesës së Prokurorisë, ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri me datë 06 Janar 2023, rreth orës 14:00, në fshatin Gotovushë, komunë Shëtrpë, me dashje ka tentuar që t'i privojë nga jeta të dëmtuarit M. S dhe S.S., ku, pas një mosmarrëveshje verbale të ndodhur aty për aty, e nxjerr revolen e markës 'Mossberg' dhe shënte dy herë duke i goditur të dëmtuarit, e që si pasojë e këtyre goditjeve lëndime trupore pësojnë të dëmtuarit, të cilët fillimisht dërgohen në Shëtitëpi e Shëndetit në Shëtrpë, e më pas në Spitalin e Graçanicës, me të cilën ka kryer veprën penale 'Vrasja e rëndë në tentativë' nga neni 173 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.5 dhe 1.11 lidhur me nenin 28 të KPRK-së", thuhet në njoftim.

Ai dyshohet edhe për kryerjen e veprës penale "përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm".

Sipas Prokurorisë, dyshohet se rreth orës 13:00 në Brezovicë, i pandehuri ka përdorur armën duarë "shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve, në atë mënyrë që me veturën e tij të markës "Golf V", në pamundësi të të kycet në rrugën që dërgon në Qendërën e Shkijimit, meqë aty kishte qenë një grumbull qytetarësh në rrugë, i njofti tkehet në drejtim të Stëhtërcës dhe me revolen e markës "Mossberg" shtëntë pesë herë në ajër, me çka ka kryer veprën penale "Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm" nga neni 356 paragrafi 1 të KPRK-së".

Krerët shtetërorë të Kosovës kanë dënuar plagosjen e të rinjve, ndërsa në Serbi ka pasur përpjekje t'i jepet konotacion etnik.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

7 janar 2023, 16:49

Shpërndaje në



Rrahje mes dy grupeve në
Klllokot, lëndohet një person

Konfiskohen armë e narkotikë
në Drenas

Shkodër, nëna e hodhi foshnjën
e sapolindur në lumë


Kosovari falsifikoi vizën,
arrestohet në Aeroportin e
Prishtinës

Arrestohet edhe një person
lidhur me vrasjen në Prizren

Gruaja në Pejë i lë të vetëm në banesë fëmijët e saj 2 dhe 3 vjeç, arrestohet

Vidhen mbi 5,000 euro në një banesë në Prizren





Koltuk masazhues profesional - 73% zbritle! Vetem 55 000 Lek

megazbritle.it | Sponsored



Business Setup In Dubai Might Be Cheaper Than You Think

Start your business today

Start Business In Dubai | Search AD | Sponsored



Shqiptari në Itali vritet nga komshiu, të cilit ia dëmtoi shtëpinë me ekskavator

Një 57-vjeçar shqiptar është vrarë të enjten në Itali. Atë dyshohet se është vrarë nga komshiu i tij pas një mosmarrëveshje. Sipas mediave italiane vrasja ka ndodhur pasi që shqiptari m...


Kohane




Apartment For Sale In Dubai Might Totally Surprise You

Dubai Villa | Sponsors

TË TJERA




Arrestohet një burrë në Suharekë pasi keqtrajtoi djalin e tij



**Operacioni "Mjegulla",
kapen edhe 6 kilogramë
marihuanë**



Arrestohet i dyshuari për plagosjen e dy personave në Shtërpçë



Arrestohen dy persona për rrahjen e një 16-vjeçari në Pejë